



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 213/4 Prot

Tiranë më 16.06 . 2015

V E N D I M

Nr 56 Datë 16/06 /2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e
Këshillit të Qarkut Gjirokastrë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e inspektimit të përgjithshëm, zhvilluar në institucionin Këshilli i Qarkut Gjirokastrë,

VËREJ:

Në zbatim të Vendimit të Komisionerit për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil nr. 12, datë 27.02.2015, "*Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë*", nga ana e grupit të punës, me shkresën nr. 213 prot., datë 27.02.2015 "*Njoftim për fillimin e e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë*", është vendosur komunikimi me institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, duke kërkuar vënien në dispozicion të materialit të nevojshëm dokumentar për realizimin në kohë e me cilësi të objektit të inspektimit.

Ky objekt, lidhej me disa institute të ligjit, ndër të cilat përmendim: lëvizja paralele, ulja në detyrë, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, duke respektuar procedurën e ristrukturimit; përshtatshmëria e përshkrimeve të pozicioneve të punës dhe e kërkesave të përgjithshme e të posaçme të tyre, me cilësitë individuale të punonjësve të mbajtur në punë pas ristrukturimit, si dhe nëse ishin mbajtur parasysh dhe respektuar kërkesat e nenit 50 të Ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar me Ligjin 178/2014 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"*", si dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*" të Këshillit të Ministrave, Kreu III "*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*".

Në përfundim të procesit të inspektimit, grupi i inspektimit ka hartuar projektraportin, dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 213, datë 27.02.2015 "*Dërgohet projekt raporti*", duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën e rregjistruar pranë Komisionerit, me nr. 213/3, datë 15.04.2015 "*Konfirmim projektraporti*".

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i inspektuar është shprehur dakort me konkluzionet e arritura nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të inspektimit, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit, në institucionin e Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Për rregullimin e ligjshmërisë së procesit, njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit në mënyrë nominale për secilin nëpunës, sipas parashikimeve të nenit 50 pika 3 të Ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*" të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i emërimit të çdo nëpunësi dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).
3. Akti i deklartimit të statusit për secilin nëpunës civil të administratës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të formulohet në mënyrë nominale dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit (dosje individuale).
4. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III "*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*" të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*" dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).

5. Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të përpilohet sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* të Këshillit të Ministrave dhe të nënshkruhen nga nëpunësi civil, eprori direkt i nëpunësit civil si dhe nga titullari i institucionit (në mungesë të sekretarit të përgjithshëm dhe të drejtorit të përgjithshëm).
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja në dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
7. Me kalimin e këtij afati , subjekti i inspektuar , Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
8. Për këtë vendim te njoftohet Këshilli i Qarkut Gjirokastrë , duke i dërguar nje kopje te raportit përfundimtar të inspektimit dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Cështjet Ligjore ,Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut prane Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA